





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2023 merr këtë:

V E N D I M
për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 30.05.2023

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për procesverbalin nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 30.05.2023.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 30.05.2023.


Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I Mbledhjes së Pestë të Rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 30.05.2023 (e martë) në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti, nënkryetari z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, znj.Marigona Avdiu, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete Rama, z.Veton Ramadani, znj.Anisë Zejnullahu, z.Reshat Azizi, ndërsa mungoi z.Sokol Shaqiri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, po fillojmë me seancën e rregullt të pestë të Kuvendit Komunal. Materialin e keni marrë me kohë. Në mesë të periudhave të dy kuvendeve pjesa e akteve ligjore të vendimeve të marra nga kuvendi, vendimet në përgjigje janë kthyer ligjshëm, mirëpo prej fillimit i kemi vetëm 2 që ende nuk na është kthyer ligjshmeria. Para se të hy në rend të ditës, kisha kalu fjalën të ju, nëse keni diçka për pyetje, përgjigje.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Shumë here në Kuvend me plotë arsye është bërë pyetje lidhur me punimet e shkollës së Pozheranit, megjithatë në inkosistenten time vazhdimisht ju kam njoftu që kryetari i komunës ka pas formu një delegacion i cili do të marrë pjesë në të gjitha institucionet e nivelit qëndror për ta parë gjendjen reale të punimeve dhe pengesave të cilët janë rreth punimeve, rreth shkollës së Pozheranit. Takimi i parë është organizu në OSHP, që kam qenë delegacion unë së bashku me drejtoreshen e arsimit dhe drejtoreshen e shkollës së mesme të ulët, Drita Pirën dhe na ka njoftu lidhur me procedurat, që konsideroj se një prej seancave ju kam njoftu. Takimi i dytë ka qenë në Ministrinë e Arsimit, gjithëhere e kam mbështet këtë takim në kuadër të ministrisë, se fillimisht buxheti ka qenë i ndarë në kuadër të ministrisë së arsimit, por në atë kohë Arsim Bajrami e ka delegu financat në Ministri të Administratës Publike dhe ata i kanë udhëheq procedurat, prandaj gjithëhere kam mendu që ata të cilët i japin paret dhe kanë të drejtën me pyet lidhur me rrjedhat e punimit në delegacion, kam qenë unë së bashku me drejtorin e bujqësisë, Naim Pirën, tu e pas parasysh kontinitetin të cilët ka qenë në rrjedhë si 2 mandate kryesues i Kuvendit Komunal dhe vjen nga i njëjti lokalitet. Ka qenë dhe drejtoresha e arsimit, njëherit edhe drejtoresha e shkollës së mesme të ulët. Gjatë bisedes ata kanë marr zotimin se, do të na njoftojnë me shkrim dhe dje e kanë dërgu shkresën dhe na kanë njoftu me shkrim lidhur me pengesat të cilat janë me keqardhje, duhet të themë me shkresën të cilën e kam këtu, që mundem me fotokopju me ja dhanë juve. Atë që kam thanë unë aty e ka përshkru atë detaj që unë kam qenë në përbërje me delegacionin. I kemi tregu që landen

e ke në OSHP. Ne kemi qenë ata të cilët i kemi tregu që është bërë ekspertiza dhe eksperti e ka dërgu raportin, dhe ato fjali të cilat i kemi thanë ne ja kanë kthyer dhe ata të OSHP-së, megjithatë po ju njoftoj se, me insistimin e kryetarit, kryetari e ka nënshkruar të premtën në Minsitrinë e Punëve të Brendshme, për shkak se Ministria e Administratës Publike tash është involvuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kemi kërkuar takimin edhe me ministrin Sfeqla, kur do të realizohet, ku jemi në pritje e sipër, por megjithatë nuk kemi hezitu në asnjë moment për çdo ditë temë diskutimi në kabinetin e kryetarit Haliti është qështja e shkollës së Pozheranit dhe insistimi i jonë që të fillojë sa më parë dhe të përfundojë

z. Ilir Zuka: Përshendetje, një ndër pyetjet që kisha me bë ishte kjo nënkryetar. Faleminderit nënkryetarë për përgjigjen. E kam parë edhe në Plus Televizion, në lajmet që ka qenë, do të ndërtohet një çerdhe në Komunën e Vitisë, që më ka rastisur aty. Komentin e parë që e kam parë, deputetja e Parlamentit të Kosovës me krenari ka thanë Qeveria Kurti 2. Këto kërkesa që jemi duke i bërë ne si asamblistë, jena pra hala në Qeverinë e Kurtit. Kur do të ndërmarrin 2 deputetët, diçka për me na ndihmuar neve Pozheranit që të kemi shkollën. Faleminderit!

z. Jakup Demiri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Nënkryetari e tha që, paska marrë një shkresë nga Ministria e Arsimit. Është mirë me pas edhe ne, se nuk po dua me diskutu, por po dua me thanë që, te ky projekt i shkollës së Pozheranit kemi qenë bashkë dhe jemi bashkë edhe ne, kemi takime me ta, ndërsa Ilir, nuk po du me polimizu, por nëse është projekti për Vitinë, për Pozheranin jemi mundu edhe te shkolla të gjithë. Puna e çerdes, mirë që është ndarë dhe me vazhdu edhe me projekte të tjera. Do të thotë është kyqja e autostrades dhe çerdhja. Kjo që janë premtu dhe që janë nda janë pak edhe kontributë i deputetëve, nuk është që nuk bëjnë asgjë. Te shkolla e Pozheranit, tashti është në OSHP lënda, ishalla nuk zgjatë, po zgjati nuk kemi çka me bë ne. Kam një pyetje, pasi është kryetari këtu, rruga që është shtruar mbi vorrezat që shkon për pjesën e lartë të fshatit, rruga ekzistuese, që është është dëmtu jashtë mase. Para kësaj mbledhje në Kuvend kam folë, por nuk ke qenë këtu. Tash, pasi je këtu po të njoftoj. Unë kam qenë te vendi i ngjarjes, i kam thirrë edhe ingjinerat edhe Rafizin, se ish menagjer i projektit, ndërsa i rrugës së mahershme kishte qenë Florim Rama edhe Florimin e kam thirrë, kemi bisedu. Unë kisha pas dëshirë me mbajtë një takim me bashkëfshatarët, me pa se çka është bërë dhe çfarë hapa me ndërmarrë për pjesën që është dëmtu. Faleminderit!

Kryetari i komunës, z. Sokol Haliti: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket aspektit të shkollës, ndërtimit të objekteve insitucionale, qeverisë qëndore, qeverisë lokale, deputët apo këshilltarëve, natyrisht ana insitucionale duhet të vlej, është aspekti procedural, insitucional, është planifikimi i buxhetit, është në Kushtetutë planifikimi, miratimi i buxhetit, si në Kuvend, Kuvend Komunal, si në Kuvend Qëndor është ligj. Ajo që parashihet, projektohet, planifikohet, miratohet në buxhet, ajo duhet mu implemtu në dinamikë, saktësi, prandaj asgjë më shumë as më pak duhet me kërku, dhe është keq që insitucionet komunale janë vendos në këtë pozitë, që tash e disa vite faktikisht me kërku që me vazhdu punimet në atë shkollë, është apsurde që arsyetimi me qenë vazhdimisht që është lënda në OSHP. Këtë nuk duhet me pranuar asnjë qytetar, asnjë individ, intelektual, këshilltar, qeveritarë, zyre, nuk duhet me pranuar këtë aspekt sikur që duhet gjithmonë adresimin me bë adekuat aty, pa dashtë me bë fajtor. Nuk është problemi këtu i fajtorit. Shkolla e Pozheranit duhet me përfundu, kjo pjesë që ka mbetë, ajo është me rëndësi, gjendja është e rëndë, këtu duhet me qenë bashkë, shkolla ka mujtë me dalë në komunë ose ministria e arsimit si sistem zhvillimor arsimor me kry obligimet e veta. Në aspektin e rrugës që e ngriti Jakupi, para kësaj unë deshta edhe një aspekt tjetër, një detyrim, një kërkesë që keni kërku raportin e auditorit të brendshëm me pru në Kuvend. Ne e kemi sjell sot, është edhe performancë, nuk është detyrim ligjor, aspekti rregullativ ligjorë Ligji për Vetëqeverisje lokale e qonë në komitet dhe aty mbetet, por ne e kemi sjellë për shkak të transparencës, për shkak të bashkëpunimit të mirë me bë, por edhe për shkak të poenave të performancës që mundemi me pas një performancë të mirë, në mënyrë që me qenë transparentë, llogaridhënës, edhe Qeveria edhe Kuvendi. Unë nuk e kam pas këtë informacion për rrugën që është dëmtu tu rregullu tjetra. Mirë që e ngrite, unë do të dalë në vend të ngjarjes, do të shikojmë me zyrtar mbikëqyrëse bashkarisht, do të punojmë ta shikojmë. Unë i di ato rrugë si janë aty, ne kemi edhe

rrugën në Terpezë, ku disa insistojshin me çdo kusht me asfaltu rrugën e vorrezave, para se mu rregullu rruga e e perme bujqësore, që del te pishat. Pjesa tjetër, Unë e kam lidhë më mirë, e duru kritika dhe 2 javë me u ndreq ajo naltëe që mos me demtu asflatin e ri. Njëjtë po na ndodhë në Radivojcë, e kemi rregullu rrugën e vorrezave shumë mirë, po për shkak të devastimit të rrugës për Gjilan, po qarkullojnë edhe veturat e rënda dhe po e dëmtojnë. Unë dje kam urdhëru që me mbyllë atë rrugë, mos me leju, për shkak që rruga e Gjilanit nuk është përgjegjësi e komunës, dhe këtu duhet me qenë të kujdesshëm, që tu e ndreq njërën me prish tjetren. Unë kaq kisha, për shkak se kam takime me KFOR-in, ju kam lajmru. Nënkrjetari është këtu, zyret janë këtu për të gjitha adresimet.

z. Taulant Haxhiu: I nderuar nënkryetar, pasi që je zëvendës i ti, unë në seancën e kalume kam mungu dhe i kam disa shqetësime. Shqetësimi kryesor është ky projekti 1 milion e 200 mijë te lumi "Morava". Ky është kry, por projektusi e ka fitu një lëndë në gjykatë, 83 mijë euro. Duhet me ditë arsyen pse është dëmtu kaq Buxheti i Vitisë. KDI na ka radhitë 24 me rend për trasparencë, barabartë me Ranillukë e Partesh. Kemi shumë kontrata me Karitas. Një e kemi përmes Zyrës së Kryetarit, një përmes Zyrës së Prokurimit. Kemi 108 vetë sipas informatave që kam, ja kam kërku drejtorit të financave, por nuk mi ka dhanë kurrë. Unë nuk jam kundër punësimit të personave. Ne të gjithë punësohemi, kush ka mundësi me punësu me dhanë një rrogë, por nuk është e drejtë mi dhanë një njeri që i merr 3 rroga me ja dhanë edhe të katërtën ne, se kemi shumë njerëz në nevojë që kanë nevojë me punu, me marr një pagë. Ne kemi shumë në lista këtu njerëz që marrin paga prej Karitasit në bazë të marrveshjes që ka bërë kryetari, që punojnë në Prishtinë e marrin rrogë në Viti. Nuk po më doket që kjo na bënë mirë edhe neve si qytetarë të Komunës së Vitisë.

z. Nexhat Halili: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Tek asfaltimi i rrugës Sllatinë-Viti. Ky projekt ka fillu së implemetuari nga viti 2020 në bazë të kontratës së lidhur me 01.10.2020, faza e parë më 27.10.2021 është lidhur kontrata tjetër faza e dytë në vlerë prej 224 mijë e 667.20 euro, mirëpo kjo kontratë nuk ka fillu së implemetuari dhe me datën 27.07.2022 kjo kontratë është ndërpre. Arsyeja është ngritja e çmimit dhe mangësitë në projektin kryesor, mirëpo kontra tjetër është lidhur në vitin 2022 në vlerë prej 554 mijë e 251.89 euro dhe pse është rritë vlera e këtij projekti. Ende ky projekt është i pa përfunduar. A keni ndonjë afat se kur do të përfundoj, se deri më tani kanë kaluar gati 3 vite ende nuk ka përfunduar, edhe pse tek ky projekt një pjesë është asfaltuar, mirëpo i lus strukturat të dalin në vend të ngjarjes, të shohin kualitetin e këtij asfalti që është shtruar. Tek rregullimi i rrugës "Ali Muhaxheri" dhe ndriçimi publik. Në shumë lokalitete rruga "Ali Muhaxheri" është një projekt i vogël i cili mund të përballohet, ngase nuk ka ndonjë kosto të madhe. E ka një gjatësi afër 300 metra, mirëpo strukturat komunale si duket nuk duan të dëgjojnë dhe të dalin në vendngjarje të shohin atë rrugë se si është e katandisur, derisa në vende të ndryshme shtrohen edhe rrugica me 5 metra e nuk shtrohet një rrugë e cila egziston shumë kohë dhe është shumë e nevojshme për ato familje të cilat gravitojnë në atë lokalitet. Tek ndriçimi publik, sidomos në fshatin tim egzistojnë shumë lagje që nuk kanë ndriçim publik, mirëpo edhe në fshatin Sodovinë e Muhagjërve, sidomos rruga kryesore nuk ka ndriçim publik. Kur do të kryhen këto punë?

z. Ali Bajrami: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Nënkrjetar, faleminderit për njoftimin rreth procedurave dhe lëvizjes që janë bërë rreth shkollës së Pozheranit. Besoj shumë që më në fund edhe kjo do të zgjidhet dhe do të vijë fundi. Pyetje për ju si nënkryetar, rreth ujësjellësit për 5 fshatra: 2 Sllatinat, 2 Sodovinat dhe Tresteniku, ku është mbërri, çka është bërë në këtë drejtim, ku dihet se uji është jetikë për çdo familje.

znj. Majlinda Shabani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë e kam një pyetje që lidhet për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ku ka qenë një thirrje për aplikim për serra. Deshta me pyet drejtorin se çka ka ndodhë me këtë thirrje, dhe pyetje tjetër, a egziston rregullorja për ndarje të subvencioneve.

z. Musli Neziri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja e parë është për rrugën që lidhë 2 fshatrat, Ballancë dhe Kravaricë. E dimë që ne e kemi votu buxhetin për vitin 2023 dhe janë ndarë mjete për atë rrugë, por pyetja është: a pritet që të fillon ajo rrugë? Pasi që rruga magjistrale Kilokot-Gjilan thuaj se është bërë e pakalushme, e bezdisshme dhe e neveristshme për qytetarët. Për fatë të keq ajo ka mbetë në mëshiren e fatit, sepse asnjë punim

nuk është duke u bërë në atë rrugë, dhe tanimë rrugën alternative qytetarët po kërkojnë rrugë alterantive dhe ju betohemi që ka qarkullim prej krejt vendeve që vinë atë rrugë e frekuentojnë atë rrugë, se ma lehtë po ju del, 1.5 km me hecë pa asflat, se sa me hecë 15 km knej në rrugës kryesore. Prandaj besoj që edhe niveli egzekutiv e dinë rëndësinë e kësaj rruge dhe është e mundur me u realizu shumë më lehtë se sa rruga magjistrale, që jemi dëshmitarë të gjithë asaj që neve nganjëhere na imponohet lëvizja për Gjilan, tu e ditë që ne edhe pa dashje mund ta hecim atë rrugë, për shkak të spitalit regjional që e kemi andej, prandaj po kërkoj që a pritët të fillojnë punimet, e që do të përfundojnë shumë më lehtë se kjo knej. Pyetjen e dytë e kam për Drejtorinë e Arsimit. Drejtoreshë, meqense në seancën e kaluar nuk ke qenë prezent, besoj që me arsye po tu drejtohem sot takimet e juaja që i keni zhvillu me zyrtarët e qendres së karrieres në institucionin e arsimit për aftesimin profesional "Jonuz Zejnullahu" në Viti, ku ju përgëzoj për bashkëpunimin me ta, por ata kanë edhe një kërkesë, besoj që edhe ti e ke marrë kërkesen. Kërkesa e tyre është përkrahja tek sigurimi aksidental i nxënësve në vendin e punës ose mësimi në vendin e punës. Te pjesa praktike që e mbajnë praktiken nëpër punëtori të ndryshme nxënësit, kur këtë e parasheh Udhëzimi Administrativ 1372020, neni 7, pika 8 dhe neni 9, pika 3, folë konkretishtë për detyrimin ose realizimin që të mbulohen nxënësit të cilët e kryen mësimin në vendin e punës, mësim praktikë. Edhe vitin e kaluar e kemi ngritë këtë çështje dhe vitin e kaluar drejtoresha u zotë që do ta gjejmë një modalitet, dhe krejtë çka kërkoj drejtoreshë, është që, në bashkëpunim me zyrtarët e qendrës së karrierës të mund të gjejmë një modalitet se si të realizohet kjo, sepse është interes edhe i nxënësve edhe DKA-së, edhe i shkollës edhe i gjithë shoqerisë. Kjo ke si kërkesë. Faleminderit!

z.Basri Sylejmani: Unë kisha me pyet drejtorin Valmir Sahitin se, është përgjegjës për fushat e sportit në Sodovin të Jerlivë. Ka bërlllog shumë aty, por ai duhet me kërku prej ekipeve a pagujnë ndonjë gjë apo jo. Është çështja e bërlllogut, nuk e mbledh askush aty, ka mbetë nëpër fushë. Edhe rruga e Sodovinës së Muhaxhereve. Më fal nënkryetar, se atë ditë nuk e kam ndegju pyetjen, se nuk kam qenë këtu. Kur do të fillon rruga e Sodovinës së Muhaxherëve dhe Jerilive, kjo e këmbësorive çka është trotuari, se njerëzit po e kërkojnë se, ka fshtra që fillojnë, që ndoshta është kërkesa më e vogël e njerëzve që ka frekuencën e tyre mes dy fshatrave.

znj.Arbnora Hajredini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ime është për listen e pritjes, listë e cila po është shumë e dëmshme për qytetarët e Vitisë. Dashta ta di, pse ende nuk jemi informuar mbi cilat parime ligjore po funksionon lista. Nuk mund të dërgohet thjeshtë një listë e cila nuk tregohet cilat janë bazat ligjore të asaj liste. Po ashtu z.Hyseni Ymeri shantazhet apo personat të cilët më dërgon fjalë nuk kryen punë. E para, unë nuk i përfaqsoj vetem interesat personale, por edhe të qytetarëve të Vitisë. Tjetra, rasti të cilin keni tentu me përdor si shantazh është rastë publik, me të po merret prokuroria edhe gjykata. Në hetime apo i dyshuar nesor mundesh me qenë edhe ti, ndoshta ka punë që jan kryer nga ana juaj që duhet të hetohen apo dyshohen. Në të janë organet kompetente që kanë me u merr për këtë rast. Besoj në drejtësi. Po ashtu besoj që nëse lista është në mënyrë të ligjshme, në kohë sa më të shkurt ka me ma sjellë ligji i asaj liste. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këto nuk janë çështje të Kuvendit. Ju kisha kërku që edhe në të ardhmen me pas kujdes këto. Vetëm mundem të bëjmë pyetje për çështje për procedura, sepse ajo është pjesë e punës sonë të përditshme që duhet ta mbajmë në Kuvend. Urdhëro z.Hysen Ymeri

Shef i personelit, z.Hysen Ymeri: Faleminderit shumë! Ndoshta nuk më takon këtu me ardhë me dhanë ndonjë interpelancë ose ndonjë arsytim të njerëzve të cilët i marrin informatat nëpër kafiteritë e qytetit. Sido që të jetë, në 3 seancat e fundit po flitet, po predikohet me emër dhe mbiemër. Zonjë e nderuar, me mu është marrë Prokuroria Publike, me mu është marrë Agjensia Antikorrupsion, me mu është marrë Auditori Gjeneral. E nij veten shumë të lumtur dhe krenar që jam njëri ndër menagjerët e personelit në shkallë vendi më i miri, asnjë vërejtje. Ju keni shku deri në Agjensi për Privatsi, nuk keni pas ku me shku se, tjerat ja u kanë hedh poshtë ato pretendimet e juaja dhe ky është dokumenti që ju është kthy juve, se nuk keni bazë ligjore, sepse procedura e rekrutimin për rastin konkretë në Drejtorinë e Bujqësisë janë kryer në mënyrën më të mirë, më profesionale dhe më ligjore. Është e vërtet se ju këtë poterë e bëni për bashkëshortin tuaj, por në fazën e rekrutimit gjatë kohës sa është procedu për rekrutim bashkëshorti

juaj ka qenë në burg i paraburgosur për shpordorim të detyrës zyrtare, ka keqpërdor edhe dashamirësinë e institucioneve komunale që është marrë me kontratë mbi vepër dhe lënda mban numer 882022. Domethanë ka aktvendim për zhvillim të hetimeve për keqpërdorim të paras publike. Shuma është marramendëse, klientët të cilët janë maltretu janë në numër tmerrsisht të madh, prandaj unë nuk jam andej, jam këndeje dhe kjo këndeje është ana ligjore. Ju mund të ankoni ku të doni ju dhe soji juaj. Unë nuk ju kam kërcnu askujt, as nuk ju kërcnova, veç atë ditë që të ju kërcënohem këtu nuk del me u ulë askush, por se nuk kam nevoj me ju kërcnu, sepse unë i kam mjetet juridike. Unë e kam ligjin, por edhe një here po ta përsëriti, prokuroria publike bashkë mendimtarët si ju që janë dhe të tjerët, Agjencia Antikorrupsion, njerëzit 25 landë i kanë qu, janë të grupit parlamentarë tëndit, LDK-së dhe të Lëvizjes Vetëvendosje. Unë i kam edhe emrat dhe mbiemrat, prandaj i qes, mos shpifni, nuk ka nevojë me shpifë ju, po shpifni dhe po doni me mbrojt burrin tuaj. Nuk mundeni me mbrojtë për veprimet e tij kriminuese të cilat i ka bërë për hajninë që e ka bërë. Unë asnjëhere nuk kam qenë në prokurori për hajni dhe për poshtërsi. Mos dil me shpifë këtu publikisht me thanë mu ka kërcnu. Unë nuk tu kam kërcnu, nuk është e vertetë.

znj.Arbnora Hajredini: Shantazh nuk thashë kërcnim.

Shef i personelit, z.Hysen Ymeri: Kjo avokatja e Lëvizjes Vetëvendosje, deshti me bë diçka me mu. Ty dhe të tjerëve këtu që jeni, me mu këto punë nuk shiten. Ana ligjore nuk shitet, sepse janë institucionet përkatëse të cilat e bëjnë kontrollin. Merre kqyre auditmin gjeneral të fundit dhe kjo e fundit tregon dhe kjo e privatsis tënde tregon urdhero kamera fokusoje që ti je Arbnora Hajredini ja zonjë e nderume kjo është ajo që ta ka kthi agjencia ke shku në prokurori ke shku në agjenci kas keni shku nuk keni bërë asgjë dhe nuk mundeni prandaj këto shpifje të ulta për një grushtë vota dhe për tendenc me degradu dikënd tjetër për me mbrojtë burrin tuaj nuk mundeni me mu nuk shiten këtë ta keni të qartë ti dhe të tjerët herave tjera jo në prokurori publike por paditeni sikur ky televizioni juaj që po ju mbështet me mu këto nuk shiten.

znj.Arbnora Hajredini: Me rastin e burrit tim janë duke u marrë gjykatat.

Shefi i personelit, z.Hysen Ymeri: Jo gjykatat, nuk i njef procedurat, merret prokuroria. Kemi dallim juridik procedural, ju nuk keni punë në gjykat ende.

znj.Arbnora Hajredini: Nuk thashë më ke kërcnu, shantazh. Po nëse përmendet emri im, ka me ja përmend burrin. Lirisht përmende, është rast i mediave.

Shef i personelit, z.Hysen Ymeri: Kur të kam shantazhu, në cilën datë, cilën orë, mos rrej, mos shpif.

znj.Arbnora Hajredini: Deri në vitin 2025 ka me diskutu për ty, deri sa të jem këshilltare ka me diskutu.

Shef i personelit, z.Hysen Ymeri: Kërkesa ime është kështu. Të gjithë ata të cilët kanë prova, kanë fakte, nëse nuk kanë kerr me shku në Prokurorinë Publike në Gjilan, unë ju thamë edhe një here, mos shpifni, sepse do t'i përdori mjetet tjera sikur që i kam përdor ndaj të tjerëve. Në fund të fundit edhe toleranca e ka një kufi, nuk ka nevojë me dalë me i marrë njerëzit nëpër gojë, me i përgoju sipas të dhënave të cilat i marrin nëpër kafiteritë e qytetit. Ki argumentin, urdhëro qoje në prokurorin publike, atje qone, aty është vendi. Keni qu rrush, keni shku me letra, asnjë nuk ju ka shkrep. E fundit është e djehit kjo.

znj.Arbnora Hajredini: Nuk dihet a e shkrep a jo, kadal mos u gut.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Janë dy çështje të cilat duhet të i kuptojmë. Një, është egzekutivi që ka dhe shërbyes publik, që janë obligativ ta zbatjnë ligjin, dhe për atë egziston dhe shkallshmëria e ankesës dhe fitimi e lëndeve, ku konsideron se një e drejtë personale e ti apo e familjarit të tij apo e personit të tretë ju ka shkel. Prandaj nuk është rastësi ky funksionim i shtetit që e ka rregullu edhe shkallshmërinë. Këtu jemi në kuvend, ne mundemi me bisedu për procedura, ne mund të bisedojmë për çështjet të vendimeve, për çështje individuale që po i qesim me emra, po mendoj që jemi lokalitet i vogel dhe nuk na ka hije dhe nderë, për shkak se unë shumë here e përdori në jetën e përditshme një terminologji, nuk bënë me folë të cilave më vonë të vjen turp prej fjalëve tua, dhe kjo vlenë edhe për nënkryetarin, kryetartin dhe çdo tjetër. Në këtë shtet tonë të brishtë duhet t'i besojmë institucioneve dhe dokumentit. Të gjitha padrejtësitë që mendoj që janë bërë në aspekt individual janë shkallshmëri. Ju drejtoheshë e

fitoni landen, i merr edhe paret në mënyrë retroaktive për atë kohë e cila tu është bërë e padrejtë dhe çdo send, ndërsa çështjet që i ngritëm, në aspekt shantazh, rren, nuk na përket si këshilltar apo si sherbyes civil, prandaj kjo është kërkesa ime, e cila duhet të shtrohet në funksion të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, të cilët ju keni dhanë nga një betim, dhe tek ai betim nëse përmbahemi do të shkojnë punët mbarë dhe mirë.

z.Remzi Salihu: Përshendetje për të gjithë dhe faleminderit për spjegimet nga të gjithë! Por, unë mendoj që ne nuk jemi as nxënës as studentë që të na rrëfëhet se si vendos gjykata, prokuroria, cili ligj është aty, cili ligj është këtu. Të lutna Bekë, ndërpreje, nuk kemi ardh në këtu me na mbajtë ligjerata edhe arsyttime. E di që ka, e di që ka edhe forma të ndryshme, që ligjet i njëf dikush pak më mirë se na dhe pikërisht përfiton prej tyre. Po se ka dallavere ka qivia këtu në Komunë të Vitisë, anekand, kjo nuk ka kurrfarë dyshimi. Kryetarit deshta me ja bë një pyetje, po iki shpejtë, se ish kan tu i ik treni, ish kanë tu e pritë kerri te dera. Nënkryetar, nëse mundesh me mu përgjigj në vend të kryetarit, mirë, nëse jo, kur të vjen kryetari përgjigjet. Dy zyrtarë të kabinetit të kryetarit, njëri është i denum me aktgjykim të formes së prer, tjetri është në procedurë, është fjala për shefin e prokurorit e që më duket edhe është ndërru shefi i prokurorit, nuk kemi as edhe një fjalë të vetme se çfarë është bërë dhe çfar ka ndërmarr kryetari me këta dy persona. Kur e ceku ligjin më heret tha se, kur të vendoset miratimi i një programi ai duhet të zbatohet. Plotësisht pajtona, por edhe për zyrtarët është një ligj i cili thotë që, nëse e shkelin procedurën, ata zyrtarë duhet të ndeshkohen e jo të avansohen. Faleminderit!

z.Sejdi Emini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Para së gjithash, ne jemi të thirrur këtu ti bimë kërkesat e qytetarëve, prandaj unë sot kam disa kërkesa. Prej fshatit nga vijë, ndriçimi publik në fshatin tonë është shumë i mangët, nuk e mbulon as pjesën kryesore të fshatit, në rrugën kryesore i kemi edhe 2 lagje, "Lagjja e Muhagjerëve" dhe "Lagjja e Vatëve", që e bënë atë rrethin e fshatit. Aty nuk është asnjë dritë e ndriçimit, "Lagjja e Mjakëve" e ka bërë vetë ndriçimin me mjete vetanake. Tek ndriçimi kemi disa kërkesa prej rinisë, që pikërisht dje janë adresu që, fusha e sportit i ka pas 6 reflektorë. Për momentin funksionon veç një dhe nuk ja lejon atyre t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive në mbrëmje. Po ashtu fshati jonë ka një hapësirë publike që e kemi cekë edhe herave tjera, janë diku mbi 10 hektarë, ajo pjesë është e dërmume, 3 hektarë i kemi mbulu dhe rregullu me mjetet tona vetanake, mirëpo pjesa tjetër është në gjendje shumë kritike, që ka mbeturina të vrazhda mu në mes të fshatit. Është mirë me ardhë me pa gjendjen në teren dhe në atë hapësirë mos me u mbjell ende asnjë dru. Është e papranushme, domethanë kushtet janë maksimale, por puna është ende 0. Kisha uru dhe klubin futbollistik të Pozheranit, jemi pjesë e Komunës së Vitisë dhe kur ka suksese e nijmë vetenen dhe ne, sepse për momentin është klub që na përfaqson si Viti, na mbronë ngjyrat e Vitisë. Për momentin është klub që është në avantazh me klubet tjera. Kisha kërku ku janë subvencionimet, të subvencionohet me një buxhet specifik, sepse është shumë afër të hy edhe në super ligë, ku neve si komunë na bënë nderë. Nuk është më rëndësi Viti apo Pozherani, aty ku janë sukseset, ne duhet të ju gëzohemi dhe duhet t'i shtymë maksimalisht. Faleminderit!

z.Naim Pira, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Faleminderit Majlindë për parashtimin e pyetjeve në adresë të drejtorisë sime. Po, është e vërtetë që ne e kemi bërë një thirrje diku në muajin e dytë për furnizim me serra, diku 100 qytetarë të Komunës së Vitisë, e di që për shkak të papërgjegjshmërisë së operatorëve që kanë konkuru në këtë thirrje është ritenderu, dhe si duket tash vonë e ka marrë epilogun final. Komisioni është tu punu në atë drejtim dhe besoj që shumë shpejtë do ta bëjmë përzgjedhjen, edhe pse me thanë të drejtën kësaj here kemi një konkurrencë jashtëzakonisht shumë të madhe, se për 100 serra me konkuru 430, kogjo ish e mundimshme, por ne ju kemi dhanë përparësi të gjitha familjeve që kanë persona me aftësi të veçanta dhe e kemi marrë për bazë atë dhe po mundohemi ata që nuk ka përfitu herave tjera, aq sa kemi mundësi me i përfshi në atë listë dhe besoj që shumë shpejtë do të bëhet transparente lista. Dhe pyetja tjetër e cila është adresu ishte se, a ka rregullore për ndarje të subvencioneve. Po Kuvendi Komunal i Vitisë, në vitin 2016 sa mu kujtohet, diku në muajin e 12 ka nxjerrë një rregullore për ndarjen e subvencioneve në lamin e bujqësisë, kulturës dhe shëndetësisë dhe po besoj në bazë të asaj rregullore është duke e kryer punën komisioni i cili është emru nga ana e drejtorisë.

z.Valmir Sahiti drejtor: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Rreth një shqetësimi që e ngriti këshilltari komunal, Basri Sylejmani rreth mbeturinave të stadiumit në Sodovinë të Jerlive, edhe pse është pjesë që i takon më shumë drejtorisë së shërbimeve publike, mirëpo në koordinim me drejtorinë do të mundohemi që me zgjidh atë pjesë. Unë kam pas edhe një takim me klubet të cilat e shfrytzojnë stadiumin "Gursel e Bajram Sylejmani", dhe prej kësaj pjese do të kisha kërku një përgjegjësi më të madhe prej atyre klubeve, në mënyrë që me rujtë ambientin rreth stadiumit. Po ashtu më lejoni për pyetjen e këshilltarit komunal, z.Emini, rreth klubit "Vllaznia" e Pozheranit. Vërtet klubi është krenaria e gjithë qytetareve të Vitisë këtë vit, në fund të stinorit ka tregu përformanca të jashtëzakonshme, ka siguru mbijetesën, ligën e parë, dhe besoj që me një kordinim të përbashkët edhe me kryesinë e klubit, insitucionet, bizneset fokusi jonë i përbashkët që në vitin e ardhshëm klubi "Vllaznia" të aspiroj drejt superligës. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport jeni të njoftum që i ka nda subvencionet dhe klubi KF "Vllaznia" nga Pozherani është i privilegjuar, është mbështet fuqishëm, është një rritje enorme nga 8 mijë euro sa ka qenë në vitin e kaluar, këtë vit është rritur subvencionimi në 25 mijë euro dhe jemi bashkë me aspirta dhe synime që kjo mbështetje vazhdon të rritet edhe në të ardhmën, që kf "Vllaznia" e Pozheranit të vazhdoj të na përfaqësoj denjësisht jo vetëm pozheranasit, por të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë. Faleminderit!

z.Arta Ajeti, drejtoresha: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Për takimet që i kam pas me qendren e karrieres në IAAP "Jonuz Zejnullahu" në Viti, i kemi diskutu edhe punën e sigurimit të nxënseve në vendin e punës, gjegjësisht në praktikë dhe këtë e kam planifiku që nga shtatori të hy në buxhet. Pra, konfrom udhëzimit administrativ Faleminderit!

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Me sa e di këshilltar i Kuvendit Komunal, çerdhja në Komunën e Vitisë ka qenë në mesin e 61 çerdheve të cilët i kanë premtu. Konsideroj ka qenë i nivelit qendror dhe fillimisht vitin e kaluar ka qenë një here e tenderume, mandej ka qenë një anulim. Kanë thanë se kanë parapa për Kamenicë, megjithatë ne kemi shtrur kërkesa dhe Vitia e kemi edhe një problem të cilin duhet ta shtrojmë këtu. Po e themë një problem, për shkak se përkundër asaj se ju si këshilltar të Kuvendit Komunal e keni pas mirëkuptimin dhe kuptoj me unanimitet të plotë e keni pas aprovu atë ndarje të parceles për ngritjen e çerdhes në komunën tonë, pastaj kemi marrë informacion se çerdhen nga planifikimet që i kanë bërë në kuadër të Minsitrisë së Arsimit e kanë delegu për me ndërto në Verban, dhe një delegacion që kam qenë unë së bashku me drejtoreshen dhe Zjadinin, dhe arsyshmërinë të cilën e kemi bërë, ka qenë dhe e kemi mbrojtë qëndrimin se, ajo duhet me qenë në Viti, për shkak se të gjitha lokalitetet, tu fillu prej Verbanit e deri në Drobesh do t'i përfshij çerdhja e cila është në Drobesh tu ndërto dhe prandaj çdo qerdhe duhet ta ketë edhe funksionalitetin e vet, edhe të rrugës edhe të prindërve të cilët gravitojnë dhe e kemi mbrojt që ajo duhet me qenë në Viti, gjegjësisht në vendin të cilin e kanë parapa edhe këshilltarët e Kuvendit Komunal. E kemi lanë shkresën aty, kanë thanë do ta kemi në konsiderat arsyeshmërinë, e kanë arsyetu sipas tyre, sipas gjendjes civile që i kanë marr ato lokalitete, shtimin e lindjet që i kanë marr dhe kanë mendu që ajo pjesë ka nevojë. Dhe një bisedë i kam tregu se, aksi rrugor është një fshatë fundor, kufizohet me Kaçanikun, po të gjithë lëvizjen në kahje të Vitisë e ka arsyeshmërinë e vetë dhe i përfshinë çerdhja në Drobesh dhe do t'i përfshinë çerdhja tjetër në Viti, që është shumë më e nevojshme, që e keni parapa edhe ju. Deri ku ka mbërri nuk kam informacion, por zotimi i tyre ka qenë që duhet me u shpallë tenderi dhe mu ndërto. Jakupi e ka marrë përgjigjen dhe nga një kopje e kanë marrë. Lumi "Morava", projektuesi i projektit e ka fitu në gjykatë, nuk kam informacione, por megjithatë e di se diku vitin 2014 – 2015. Taulant mos u lidh për viti, saktësisht ai ka qenë shumë here në zyren time, nuk kem qenë ne që i kemi thanë nuk jemi për pagesë të asaj, megjithatë ka mungu një dokumentacion, se hartimi i projektit të hapjes së planit të lumit "Morava" është bërë në kohën e kryetarit Nexhmedin Arifi dhe ne i kemi thanë sjellje një kontratë të cilën e ke një marrëveshje që duhet me pas një bazë ne për pagesë, se Komuna e trashëgon edhe borgjet e mëhershme dhe sipas projektuesit të cilin unë edhe sot bisedoj me të. Ka thanë e ka marr në aspekt gojor, në aspekt gojor ti e din institucioni nuk ka mundësi me pagu dhe kjo ka qenë mos kuptimi jonë, se nuk ka pas bazë ligjore, marrëveshjen të cilën e ka pas të nënshkruar që na kish obligu, megjithatë ndoshta e ka fitu.

Tash nuk e di në rast se e ka fitu, është djersa e ti, e vendos gjykata, pavarësisht që nuk më konvenon ai vendim, por është i zbatueshëm dhe i egzekutueshëm. KDI në vendin e 24 i ka ato indeksat e vetë të cilët të matë tashe ka parapa unë një prej saj që kam qenë shumë aktiv në atë drejtim, e kam parë një padrejtsi që qdo përgjegjës besoj se në fushën e vetë e shef ku e ka vendin kam informacione se sa i përket pjesmarrjes së femnes në degjime bugetore na kish radhitë në vendin e 3 që unë konsideroj gabim se është dashtë me qenë në të parin përshkak se kam qenë pjes aktive dhe përqindja që e thirrë atë të njejtin ditë e kam thirr por ishte në pushim mjeksorë se ma ka dërgu në zyren time por tash nuk munda ta gjejë në zyren time dhe ai e ka atëhere më ka pas raprtu nënkryetarë se pjesmarrje e femres në komunën e Vitis në degjimet bugetore ka qenë vitin e kaluar 51.5 me 48.5 51.5 ka qenë e gjinis femrore dhe atëhere nuk ka asnjë arsyesheri me pasë vendin e 3 mundemi me nda venidn e parë me dikëndë tjetër por vendin e 3 jo, te karitasi nuk e di numrin e saktë megjithatë e di që kemi është e vertet që janë 2 marrveshje ajo që e kam konsesituse dhe nuk ma merr mendja që ka persona me 2 rroga un po themë për këtë hajde në zyrë me lajmro në momentin që e di që ka do të intervenojë për me u largu nga aty, rruga Sllatinë e poshtme e di që e kemi marrë konfirmimin e inxhinerave që përfundon së shpejti fjala është për Viti-Sllatinë te kualiteti ajo kërkohet në maksimum por megjithatë e di që qdo pranim i rrugës dhe i objektit formohet një komision për pranim teknikë unë mundem me dalë me nejtë veq në asfaltë por lidhje nuk kam me atë punë duhet me qenë njeri profesional për atë qëshjtje, rruga Ali Muhaxheri nuk e di a është në prjektë në rastë se është në projektë ajo duhet të kryhet e di që shumë here e ke përmendë e ka përmende edhe kryetari kshillit të fshatit por tash saktësishtë krejtë rrugët nuk i di në rastë se është në projektë mundet mu vanu por mu kry kryhet, Ali po besoj që e kemi bërë një hapë dhe po shpresoj në drejtim të mirë pas një presioni të vazhdueshem 5 kryetarët të fshatrave të cilët kanë qenë në kontaktë në vazhdimsi me mu presioni ka qenë i vazdhueshem që me të vërtët ato 3 lokalitete për mometnin që besoj kan me fillu edhe në lidhjen e kontratave individuale kan kalu në menaxhim të hidromoraves përshkak se kan kyqjen individuale Sodovina e Jerlive qerkezve dhe Tresteniku nuk është për 2 Sllatinat se në kontrata është për 5 lokalitete i kemi shkru 3 konotrata i kan nda 2 Sodovina në vete Tresteniku dhe 2 Sllatinat përshkak se 2 sllatinat kemi morrë edhe komuna disa obligime sejanë disa defekte tëcilët duhet mei menjanu ne dhe është kërkë në hapin tjetër që un kam kërkë për ujësjellsin eVerbanit dhe Smires me bë një prerje përshkaks e ka qenë mollë sherrri CDI për mua me kqyr cilat punat janë pa kry dhe qka mundemi me bë për hapa të më tutjeshem është kërkë në takim dhe do të thirret edhe kryetari i kshillit të fshatit që me bë kyqje Goshica që me fillu edhe Goshica me pasë një marrveshje dhe me kalu në menaxhim të hidromoravës penges na kan paraqitë të Zhitia përshkak se lënda operatori ekonomikë që i ka kry ish në arbitrazhë që unë e kam kontestu dhe së bashku me zyren ligjore kam dhanë një opinion ligjorë punimet të cilat jan kry dhe lënda është në arbitrazhë nuk e pengonë qështjen e ujit me marrë në menaxhim se ato provat mbesin qka jan kry punët ne nuk jemi tu i kontestu ti ki me marrë në menaxhim kontrollimin e ujit me fakturu dhe me hecë përpara dhe e kemi qu shkresen që në këtë drejtim nuk ke asnjë penges një hapë i vonuar por besoj që e kemi bërë një lëvizje të vogël në adresë të kësaj qështje të mirë dhe duhet të vazhdojmë gradualishtë që viti 2023 dhe viti 2024 të avanson qështjen eujit në komunën e Vitis se kemi qenë keq dhe sot jemi keq prapë por megjithatë e di që një prej kshilltareve më ka thanë gjithmonë nake thanë fjalët e nejtja po ai nuk ka ardhë me kqyr qfar angazhimi bëhet rreth këtyre gjithëhere dalke një penges sa e elemijoshe këtë dalke tjetra që kur nuk varen krejt prej teje ndodhin edhe këto zhagitje, Mus unë besoj që së shpejti ka me u bë kjo por ishalla nuk bëhet edhe ndonjë ditë na e shkatrrun rrugen Remnik për Nasal krejtë veq anamorava që jemi duke e duru këtë gjendje të rrugës Ferizaj-Gjilan nuk kish lokalitet në Kosov që e kish duru këtë turturë megjithatë kemi këtë gjendje, këtu ka operatore ekonomike që nuk kan qare pa shku, rruga na është shkatrru me kamiona për këtë në këtë drejtim të kisha thanë insisto mos me nisë ne të shpëtojnë se bëhet sikur e Jakupit që tha tu e ndreq një tjetër e prishim dhe atë popullata kërkon dikun një rrugdalje një zgjidhje me të vertet jemi në një gjendje shumë të rendë, Basri qështja e trotuareve besoj që është në procedurë por kur mos më lidhë me afat se ato po lidhën qështjet procedurale aty është e parapame dhe ka me u kry, Remzi po tregoj me sinqeritetin më të madhë the për kabinetin e kryetarit nuk kemi të konfirmuar në aspekt zyrtarë në momentin që e

kemi të jesh i bindur që i marrim konform të ligjit gjitha hapat jo për tjetër po i marrim në radhë ta parë me mbrojtë veten se kërkohet gjithëhere pytsori bën pyetje në kabinet të kryetarit a ki persona si sherbyes civil me aktakuz të ngriturë por zyrtarishtë nuk kemi asnjë shkresë te qështja e prokurimit edimë që nënshkrimin ja kanë marrë por nuk kemi diqka tjetër dhe është zëvendësu me puntor tjetër nuk e lunë rolin e menaxherit e kemi marrë në konform ligjit. Sejd te qështja e ndriqimit publik në seanen e kalum të ka tregu edhe Basiru përshkak të një kontrates të madhe të cilën e kemi nuk kemi tash kompani kontraktuese që na mirëmbanë dhe nuk ka ndodhë vetëm në Goshicë por shumë vende në lokalitete të cilat kemi defekte por besoj që së shpejti do ta zgjedhim këtë qështje, këto që po i kërkon është mirë që i keni 10 hektar të fshatit problematika është me e rregullu edhe tektashin se është siperfaqje e madhe qështja e hudhjes së mbeturinave na u ka bërë si model nëpër lokalitet edhe pse gjithëhere ju thamë inspeksioneve me dalë dhe me i gjobit unë besoj që kishte me qenë mirë me caktu diqka në qështjen e fshatit me pasë një projektë edhe për drunjë por edhe ulse me i ngjasu një parku, tek subvencionet ka qenë një vendim i kryetarit të cilin e keni aprovu ju edhe dyfishimin edhe në kultur sport rini dhe në bujqësi edhe pse e kemi parë që edhe ai dyfyshim nuk është i mjaftueshem ka qenë një intervenim edhe pas 100 mi eurove i kemi bërë 110mi dhe prapë është problematikë për nevojat të cilat i kërkojnë përshkak dhe mungesa e një kulture apo spo di si ta quaj sportive në komunën e Vitisë që kam parë që ende nuk kemi biznese që me të vertet i subvencionojn klubet të cilët dojnë me i pa në ligë të parë apo super ligë sikur që e kishim ekipen e femrave, insistimi i kryetarit është që sërishhtë me bë rritje edhe në kultur rini dhe sport edhe në bujqësi, përshkak të kerkesave të cilat janë të vazhdueshme Faleminderit.

z.Besnik Imeri, Drejtori: Përshendetje për të gjithë! Unë kisha pasë me plotësu nënkryetarin, ndoshta te hapësira gjelbruese për asamblistin Sejd. Aty e kemi një projekt. Në projektim e sipër të kisha me preferu me ardhë dhe me kqyrë se çka mundemi me futë në atë projekt. Për në Ballancë - Kravaricë ja dërgova linkun ndriqimin publik. "Ali Muhaxheri" duhet me shiku dhe të tregoj. Sllatinë -Viti kryhet sivjet, edhe për një takim me mbajt në Smirë me fshatarët dhe me inxhinerat me kqyrë çka ka ndodhë në dëmtimin e rrugës dhe riparimi normal që na takon neve si komunë. Faleminderit!

z.Ilir Zuka: Nënkyetar, edhe Jakup. Jam shumë i lumtur që ajo çerdhe do të ndërtohet në Komunën e Vitisë. Përshembull, se po mirret për keq, pe ndrron lokacionin, po del keq, se Iliri ish kundër. Jam shumë i lumtur, një investim prej Qeverisë së Kosovës është tu ardhë në Viti, po unë po kërkoj që të bëhet më shumë presion që edhe shkolla e Pozheranit të lëviz. Unë e kam një propozim për drejtorin e kulturës, nëse ka mundësi në seancën e ardhshme me sjellë rregulloren për subvencione, me rishiku dhe me rregullore me cekë aty, jemi faleminderues në emer të klubit futbollistikë "Vllaznia" për përkrahjen e vazhdueshme që e ka bërë Komuna e Vitisë. Unë me rregullore jam i bindur që edhe kryetari edhe të gjithë ju pajtohej me këtë propozim që e themë unë, që OJQ profitabile që përfitojnë mos të jenë përfituese prej Komunës së Vitisë, se është shkelje e ligjit.

Nënkyetari i komunës, z.Hasan Aliu: Takimin që e kemi pas, kryetari ka dalë me një propozim që e kanë lanë në muajin tetor ose nëntor, nga kjo rregullore me dalë me një vendim gjeneral që, me përcaktu dhe me ja letsu punën komisionit dhe kemi mendu ne ta kemi zotimin, edhe përfaqësuesit e këtyre që i kanë dhanë mbeshtetje që i ka dhanë komuna për zhvillim të aktivitetit dhe ta bëjmë një vendim gjeneral që do t'i specifikon këto dhe do t'i letson punët për të gjithë

z.Ilir Zuka: Isha edhe unë me përfaqësuesin e Vllaznisë me nënshkru kontratën. Jemi kqyrë me një sy shumë të keq, po kur i llogarisim shpenzimet që i bëni ju me krejt organizatat tjera, janë 0. Unë e di që Komuna e Vitisë nuk mundet me na mbulu si klub. Jemi faleminderues për përkrahjen maksimale që e ka bërë këtë vit.

z.Valmir Sahiti, drejtori: Egziston një rregullore 042017 e Qeverisë së Kosovës, e cila me hyrje në fuqi i ka hudhë poshtë të gjitha rregulloret komunale. Prandaj është e vetmja rregullore që komisioni e ka të drejtën e shqyrtimit dhe komisioni duhet të vendos në bazë të saj, për shkak që është rregullore qeveritare.

z.Ali Bajrami: E mirëprita ndërtimin e çerdhes në Komunën e Vitisë, po pas njoftimit të nënkryetarit edhe ndërrimi i lokacionit për mua është shumë shqetësuese. Pse po e themë këtë. Me planin zhvillimor aktual hartat

zonale në atë pjesë nuk është parapame mu ndërtu çerdhja. Plani zhvillimor komunal që është duke u punuar, që nuk ka përfunduar. A mos është kjo një lajthitje mos me u ndërtu kjo çerdhe, se ne e dimë që edhe këtu kur e kemi nda lokacionin do të kemi probleme. Prandaj, me ndërrimin e lokacionit, tenderin ku do ta ndërtojmë ne atë çerdhe në vedin në Kuvend, nuk kemi marrë lokacion, nuk kemi caktuar çka është pas krejt kësaj duke u fshehtë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Për lokacionin të cilin e kemi nda e kemi vendimin e ligjshëm të MAPL-së dhe në bazë të asaj ajo mund të ndërtohet, nuk bjen ndesh me planin zhvillimor.

z.Taulant Haxhiu: Nënkrjetar, projekti po thua që ka fillu te qeverisja Arifi, ka përfunduar Haliti. Përgjegjës i saj është kjo qeverisje që unë jam bashkëqeverisje me të. KDI e ka qitë këtu ku është, te punësimi në Karitas. Beso, kurr nuk thotë Taulant Haxhiu qëtu diçka pa u vërtetu mirë, se me i përmend 108 emra, jam person politik, por beso që këtu ka njerëz që marrin rroga pa qenë kurr në komun, pa ardhë kurrë, pa e ditë ku është dera e komunës. Unë e di që ti të ishe i pari i komunës nuk e bënë një gjë të tillë, por e kanë bërë të tjeret, por ai që deshta me ja bënë këtë pyetje, ai heci, ministri i diasporës, kështu që, beso edhe njëherë po them, nuk thotë diçka Taulant Haxhiu, diçka që nuk është e vërtetë, nuk kam nevojë me përmend emra, por që do kurdush ti për hir të opinionit ti them. Ne jemi të interesum me punësu njerëz, por nuk jemi të interesum njerëz që kanë komoditet me marr edhe një rrogë, se kemi shumë njerëz pa rroga.

Nënkrjetari i komunës, z.Hasan Aliu: Taulant, të kisha këshillu për një çështje, ikni emërtimeve. Unë do të isha shumë i kënaqur në rastë se e kishim bërë minister të punëve të jashtme jo veç Sokolin, por cilindo prej Vitisë, por megjithatë të ja thojmë titullin ashtu si e ka, ai është krytari i Komunës dhe në rast se ti së bashku me këshilltarë e konsideroni se thirja e ti sot në asosacion për gjendjen e krijuar në territor të Kosovës, edhe ai për atë punë e ka nënkryeatrin.

z.Jakup Demiri: Deshta mu kyq në disa prej pikave si shef i grupit parlamentar. Pyetja e parë kishte të bënte me drejtorin e bujqësisë. Drejtori tha i kemi 100 serra me i nda, ndërsa i kemi 430 aplikues. Deshta me pyet, puna e komisionit, e keni ndonjë nga shoqëria civile, a lejohet se nuk e di edhe ndokënd nga opozita, pasi që e dimë që vitet e fundit Drejtoria e Bujqësisë ka pas disa probleme pikërisht me këtë çështje. Çerdhja në Verban që u cek nga nënkryetari, ministria ka gjetë një dokument të mëhershëm nga Komuna e Vitisë, që janë të caktume 3 apo 4 lokacione për ndërtim të çerdheve në territorin e Komunës së Vitisë. Me gjasë këtë që e kemi nda në Kuvend Komunal nuk ka të bëjë kjo me ndërtimin e çerdhes, po është një dokument që është gjetë më ministri si kërkesë e Komunës së Vitisë dhe si lokacion më i madh ka figurë Verbani. Kështu më është thanë në Prishtinë. Dëgjimet publike, nënkryetari tha nuk po lshohem, por të dëgjimet publike. Nuk e di sa vlenë nëpër komunat tjera, por në komunën time e di si bëhet dëgjimet publike, i bëjnë më shumë që të bëhet një dokument. Dëgjim publik në Komunën e Vitisë nuk ka. Ujësjiellësi, nënkryetar po mundoheni me i ikë përgjigjes. Nuk po dua me ju ataku juve se, nuk i bëni politikat në Komunën e Vitisë, i bëjnë tjetër kush. Në vitin 2021, Viti, kryetari i Komunës së Vitisë ka promovu diku 10 apo 15 ujësjiellës si projekte të implementume, e ujë nuk ka. Ky është mashtrim, mos ta zbusim hiq, e kemi një problem të ujit që nuk jemi marrë fare me ta, e kemi pas lanë në dorë të dikujt në rahmet, e tash e kemi gjendjen si e kemi. Vetëm në Smirë për 4 vite sa kam qenë unë asambleist janë hapë 217 bunare. Vetëm nga 1 mijë euro po të kishte kushtu një, bëjnë 217 mijë euro. A ish dashtë vlerë më e madhe për rritje të kapacitetit. Matematika shumë e thjeshtë. Edhe për ty kryesues e kam një vërejtje për debatin të zotriut, që nuk është këtu. Nuk deklarohet, se unë për vete do të reagoj, se personi që ishte këtu dhe e merrë fjalën kur ti mteket, diskuton aq gjatë brenda, na krejt e njohim, i njohim zyrtarët në Komunën e Vitisë dhe folë për dikënd që nuk ka përfunduar procesi për bashkëshortin e saj. Nuk di ndonjë gjë, është në proces, por për këtë e di edhe lëndët që i ka pas në gjyq, edhe lëndët që i ka hupë atje në shkollën e Smirës dhe ta merr këtu bahet kapada i Kuvendit Komunal të Vitisë. Kuvendi është i asamblistëve, në radhë të parë e mandej është i zyrtarëve dhe i gjithë qytetarëve. Për këtë ta jap vërejtje edhe si koleg dhe si pjesë e këtij kuvendi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ja dhashë fjalën, sepse Arbnora 3 seanca ka kërku dhe bëri pyetje. Unë fjalët askujt nuk mund të ja mati çka fol, mundohem me reagu mi mbyll kur tejkalohen, mirëpo zyret kur marrin pyetje kan të drejtë të përgjigjen edhe para anëtarëve të kuvendit.

z.Jakup Demiri: Është kriju një atmosferë këtu prej personit në fjalë që, nuk e meriton me nejt në sallë të kuvendit. Ne i dimë edhe fyrjet edhe sharjet që ju ka bë edhe më heret, i njëjti është, i dimë për të gjithë zyrtarët tanë të pakten këta çka i kanë bërë nga 7-8 vite tu punu.

znj.Arbnore Hajredini: Ajo çka ndodhi me atë ke që, dashti me mbrojtë vetën e për me mbrojtë veten është më i mirë sulmi. Unë nuk kam bërë kërkesë për hetime në prokurori. Unë nuk e di çfarë letre e pat ai, por nuk ka lidhje, besoj që ndoshta prokuroria vet po lëshojka letra. Nëse e dëgjon seancën, nënkryetar përgjigjen nuk e morra. Dëgjova çka ka ndodhë me burrin tim e jo për ligjin e listës së pritjes. Është e treta seancë që jam ka e kërkoj, mundet me ardhë shumë më thjeshtë me pru atë ligj dhe jo me bë gjithë atë zhurmë, por ka kush merret edhe me të.

znj.Majlinda Shabani: Pata një replikë ndaj drejtorit të bujqësisë, po nuk është këtu thirrja, është bërë me 6 shkurt edhe ka pas me përfundu diku me 20 shkurt. Veç se e dëgjuat zotimin e tij, por tash prap se prap konsideroj që është vonë, për shkak se e dimë që koha për mbjelljen e serrave ka kalu. Diçka tjetër që më ra në sy, që për mua ka qenë shqetësuese, te thirja që është bërë, ku thuhet që, thirrja është bë në bazë të kërkesës së fermerëve, e që realisht çdo thirrje për subvencione e dimë që duhet me u bazu në statut, në vetë rregullore të komunës, e kjo konsideroj që është shkelje ligjore. Domethanë e din që planifikimi buxhetor bëhet në bazë të kërkesës së fermerëve, mirëpo kur bëhet shpallja për subvencione, duhet me u bë në bazë të rregullores që parashihet, se mandej aty vendosen kriteret që duhet me i plotsu ato kriteret. Çështja tjetër është që kemi numër shumë të madh të aplikuesve edhe pajtohem plotësisht, mirëpo kjo vie si pasoj e mos menaxhimit të mirë ose keq planifikimit që drejtori pikërisht në shpalljen që e bënë nuk i ka të planifikime mjetet ose numrin e serrave se sa ka me i nda. Kështu që unë kisha dashtë këtu me ngritë një shqetësim ndaj drejtorit që me pas parasysh. Pajtohem plotësisht me shefin e grupit në përfshirjen e komisionit, që duhet me pas përfshirjen e personave të tjerë. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Besoj që te çështja e shpalljes dhe aplikimit, ato kanë qenë procedura. Nëse komisioni është bërë jashtë rregullores, ajo nuk guxon me kalu, por tashti duhet me u bë në bazë të rregullores.

z.Ali Bajrami: Jakup, nuk e kam për polimikë, veç me sqaru deri në fund. The e kanë gjetë një dokument, ai dokument a është vendim i kuvendit apo vendim i kryetarit, i Drejtorisë së Urbanizmit, se tek vendimet varet se çfarë vendimi, sepse edhe vendimi e ka afatin kohorë, se nëse brenda afatit kohorë veprohet, po unë nuk e di a ka naj kërkesë a naj tender. Ne si Kuvend kemi marr vendim, kemi caktu lokacion. Edhe nënkryetari e shpjegoj a është tu bë kjo në koordinim me Komunën e Vitisë apo ata në bazë të qatij dokumenti, që unë nuk po e di çfar dokumenti dhe i cilit vit është e si janë tu vepru me atë çerdhe, a janë tu e zbatu vendimin e Kuvendit Komunal.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu: Jakup, me sinqeritet më të madh po të thamë që, mu nuk me kanë thanë që kanë dokument, munden me pas po mu nuk me kanë thanë. Unë e thash atë që me kanë thanë, ata e kanë marr për bazë gjendjen civile, numrin e të shtume të asaj pjese, e kur e kanë pa shkresën tonë të cilën e kish përgaditë punëtori në DKA, e ka arsyetu, e pasi e kanë marr shkresën na kanë thanë, do ta shqyrtojm, e besoj që kanë me pas mirëkuptimin tonë, sepse duhet të ndëgjohe zëri i Kuvendit Komunal, sepse edhe ju keni votu për ketu me qenë. Arbnora, unë edhe njëhere po të thamë, mos me qenë aspekti i bazuar në ligj nuk ja pranojnë me i shti në sistem të pagave, këtu duhet me pas të kjar. Unë ta kam thanë atë ditë, po ta thamë prapë, hajde në zyre të gjitha ato padrejtësi që mendon tu kanë bë, ndjeke rrugën ligjore. Majlinda, unë nuk e pasna pa thirrjen, se jam jurist, që nuk koka shënu ajo pjesë që po e thu ti, edhe unë pajtohem me këtë. Po kur po thu ti që është keqmenaxhu, sa po e ndreq të parën, dytën po e prishë krej e nuk po muj mu pajtu me këtë. Pse nuk po qohesh me thanë, o na mytën me rrugën Viti-Gjilan. Nuk ja kisha thanë këtë, po, po më shtini me thanë. Jam i bindur që, me pas qenë në qeveri LDK ose PDK, ju kishit blloku përditë. Pse bre nuk e thuni që na shkatrrut krejt, naj bat jetën monoton. Çështjen e ujit. Jakup, ju kam tregu, vazhdimisht ka qenë një marrëveshje në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, CDI-së, që për

implementim dhe kur ka pas mirëkëptim. Kryetari ka thanë, unë po participoj me mjete, vetëm hajdeni rehabilitimi 13 fshatra.

z.Jakup Demri: Qytetarët i keni lanë pa ujë, nuk është faji i juaj nënkryetar, nuk jemi kanë bashkë hiç këtu, i keni gra ju siç keni dashtë, po sot e keni lanë pa ujë qytetarët. Që katër vite që jam këshilltar e kam këshyrë, janë hapur 214 puse. Me pas pas ujë të pijes nuk ishin hap këta puse. Tek puna e çerdhes që po flitet, ju në 2017 i keni premtu katër çerdhe brenda 6 muajve e nuk e keni bërë kurrja, e keni premtim këtë.

z.Basri Sylejmani: I kemi dy deputetë në Parlamentin e Kosovës, asnjë fjali nuk e kanë fol për shkollën e Pozharanit. Edhe për ujë, Sadovina, Tresteniku edhe Sadovina e Muhagjërve ujë kanë që një muaj pa ndërpre, e kanë pagu nga pak, po kryesorja ujë kemi edhe kemi shumë.

z.Majlinda Shabani: Te thirrja që është bërë, është bërë në bazë të kërkesës së fermerëve, nuk ka të cekur as statut as rregullore për ndarje të subvencioneve e që është shkelje ligjore. Nënkryetari tha, po thu keqmenaxhim, është keqmenaxhim, është keqplanifikim. Pse është, për shkak që në pasqyrat financiare të vitit 2022 e ki vetëm 85% të buxhetit të ekzekutuar. I ki dikun 55 mijë euro që të kanë tepër prej buxhetit e që në fakt këtu ke mujt me bërë menaxhim me të mirë, ke mujt me shtu kapacitetin në subvencione, e tash të kanë aplikuar 400 aplikues. Në bazë të qkajit kanë mu bazu ata aplikues, edhe ankesë që kanë me bërë, p.sh.: une kam aplikuar edhe mu ka bërë e padrejt, në çka mu bazu që nuk kam qenë përfituese, kur nuk e ke cek as statutin, as rregulloren. Kështu që, të lutem me qenë me serioz, edhe çështjet që i diskutoj unë, pa i analizu mir nuk dal.

z.Naim Pira, drejtor: Siç e ceka edhe më herët, është një rregullore e cila e rregullon çështjen e ndarjes së subvencioneve. Është e vërtet që kanë konkuru shumë fermer, është e drejtë e tyre me aplikuar. Në momentin që mendon që tu ka bërë padrejtësi, e ki komisionin për shqyrtim e ankesave, e të jeni të bindur që pargjykimet nuk baj.

z.Taulan Haxhiu: Kryesues, kur ka qenë kryesues i Kuvendit, z.Pira, ne shefat e grupeve parlamentare e kemi pas një minutazh me të madh. Ti e ke përzi krejt, as dy fjalë nuk po i foli unë. Është mirë me ba një far reni kush me fol. Po del prej kontrolles, kush po do po fol. I nderuari nënkryetar, Viti është vendbanimi më i madh në Komunën e Vitisë, e në qytet po ndërtohen banesat nga 15 -16 kat. Ato kanë me u mbushë me banorë. Na nuk kemi kapacitet të ujit hiq, na e kemi ujin zero në Viti, nuk ka hiq ujë të pijshëm. Na është mirë me nda mjete për shtimin e kapacitetit të ujit e jo me maru sheshe. Më mirë me pas ujë të pijshëm se sa me maru sheshe.

Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu : Kemi me shpronësu, kemi me bërë projektin edhe kemi fitu projekt prej Bankës Botërore për shtim të kapacitetit të ujit. E dimë gjendjen, por po këto nuk bëhen për një ditë.

z.Bekim Azizi, kryesues: Taulant, shefi i grupit tek pyetjet e përgjigjet, nuk është ai me i bërë 5 pyetje e të tjerët nga dy. Shefi i grupit çdo pikë të rendit të ditës me rregullore mundet me fol në emër të grupit dhe ka minutazh me dy fishe e jo tek pika jasht rendit të ditës.

z.Jakup Demiri: Për drejtorin e bujqësisë, 400 aplikues për 100 serra. Ne komisionin që e keni formuar, nuk e di si e parasheh rregullorja, deshta me pyet: a keni naj anëtarë të komisionit nga shoqëria civile apo nga opozita?

z.Sejdi Emini: U diskutu shumë vend e pavend tek shkolla e Pozharanit. Ti kyesus po do me e nda fajin në tri pjesë, e që unë nuk mundem me e marr fajin e përbashkët. Është një projek që ka fillu shumë heret, duhet me pa kur ka fillu, kush e ka projektin, kush e ka punu edhe kur ka pas me përfunduar, se tash ata njerëz që kanë qenë të përgjegjshëm i kanë përzi edhe procedurat ligjore. Kushdoqoft ai, nuk mundet me i shkel procedurat ligjore e me punë jami tu i bajt pasojat e atyre të mëhershmeve.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Tek shkolla e Pozharanit, janë disa procedura që janë shkel, pastaj nënkryetari tha, rruga Kllokot-Gjilan. Po është e vërtet, edhe tha na si këshilltar nuk po na intereson a po demtohet apo nuk po demtohet. Nuk e din nënkryetari se sa jemi intertesu na, nuk e din a kemi bisedu a jo, e unë po i thamë që e kemi bisedu edhe na edhe ne jemi që t'i shtyjme intereat e qytetarëve pa marr parasysh se çfarë partie është.

z.Nexhat Halili: Rruga Killkot - Gjilan është e stërgjatur, kjo është evidente, mirëpo stukturat ujore duhet t'i shofim edhe projektet tjera të komunës. Më heret e potencova rrugën Sllatinë – Viti, që dikun tri vite e ndoshta edhe katër vite. Trotualet fillojnë e zgjeten nga dy tri vite.

z.Naim Pira drejtor: Taulant, kryesuesi është tu bë përpjekje me e mbajt renin e rregullen me e zbatu rregullore. Po unë nuk po shof gadishmëri nga ana e këshilltarëve komunal që të zbatojnë rregulloren e punës. Sa i përket pyetjes se parashtru nga Jakupi, për komisionin, unë e di që janë dy rregullore për ndarjen e subvencioneve. Një e vitit 2017, të cilën e ka miratu ministria dhe kryesisht ajo ka të bëjë për ndarjen e subvencioneve në kulturë. Po aty konkurojnë OJQ-të, e aty në komision duhet të jet një nga shoqëria civile, e ndërsa në komisionin për bujqësi kryesish duhet të jenë shërbyes civil, e nuk e di cilit subjek i përkasin. E di që në drejtorinë time kam zyrtar që hiq nuk i prkasin as një subjekty politik, po mundohemi me e përcjell rregulloren.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Faleminderit për kontributin e dhanë, matrialin e keni marr me kohë, për këtë senacë kemi këtë rend dite.

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitin 2021 në vitin 2023.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitin 2022 në vitin 2023.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndertimin e objektit për personat me aftësi të kufizuara në fshatin Binçë me Nr. 01-110/05-278 i datës 30.03.2023.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e vendimit për Planin Komunal të Veprimt për Energjinë dhe Klimën (PKVEK) 2022-2030, me Nr. 01-101/05-164 i datës 01.03.2023, dhe vendimin për Planin Komunal të Veprimt për Energji dhe Klime (PKVEK) 2022- 2030 me nr. 01-110/05-1364 i datës 05.12.2022.
7. Informatë, manifestimi tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2023".
8. Raporti vjetor i punës për vitin 2022, Njësia për Auditim të brendshëm në Komunën e Vitisë, (pa diskutim në KPF).

A kemi ndonjë diskutim për rendin e ditës?

z.Nexhat Halili: Për drejtorin e financave, për propozim vendimin për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023. Duke u bazuar në Ligjin 03L, rritja e buxhetit. Mu po më intereson rritja e buxhetit në bartjen e të hyrave. Tash kjo është pika e rendit të ditës dy, është e njëjtë me pikën e rendit të ditës tre dhe katër. Tash në fillim thuhet, rritja e buxhetit, e keni cek edhe vlerën në çka e keni parapa këtë rritje nga vitit 2022 në 2023, kur në arsyetim e potenconi bartjen e të hyrave. A është bartje e të hyrave apo është rritje. Unë po tham që, pika nr. 3 e 4 janë të njëjta me pikën 2 të jeket nga rendi i ditës. Unë po kërkoj prej drejtorit, pse ka ardh kështu.

z.Besnik Imeri, drejtor: Nexhat, është e vërtet që qysh po thu ti është, po është propozim i Ministrisë së Financave. Ata kanë kërku me i nda, kështu, se e dimë vitet tjera si kanë shku, po kështu ka propozu ministria këtë vit.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Qes në votim miratimin e rendit të ditës, me ngritje dore. Me votat e të gjithëve miratohet rendi i dites.

Si pikë të parë të rendit të dites kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal

Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. A ka për diskutim. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim për miratim. Me 24 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e dytë e rendit të ditës kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023

z.Besnik Imeri, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë që ta aprovon propozim vendimin për rritjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të vitit 2022 dhe shpërndarjen në vitin 2023. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, neni 9, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 1,2 dhe 6, bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave për rritjen e Buxhetit Komunal në vlerë prej **195.500.14 €** të vitit 2022 në vitin 2023. Matrialin e keni pranë me kohë, për pyetjet shitesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Nexhat Halili: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë edhe me herët kur bëna kërkesë për largimin e kësaj pike, e elaborova pak, po edhe tani pak po e elaboroj, mirëpo pika dy, tre dhe katër janë të ndërlidhura të gjitha pikat, shuma 195.500.14 euro të cilat rriten e barten prej vitin 2022 në vitin 2023 dhe të gjitha janë për shkak të tejkalimit të të hyrave vetanake. Unë i kam pasqyrat financiare të cilat janë paraqitë më 30.01.2022. Po ndërlidhem prej shkallës së realizimit 119.79 %, që në kuadër të kësaj janë edhe këto të hyra vetanake që janë cekur si rritje e buxhetit. Po tek pika 1, që ju me siguri nuk e keni me veti, e une i kam pasqyrat financiare tek dënimet e trafikut, dënimet e gjobave, gjykatave, dënimi i pyjeve, në planifikim nuk janë paraqitë, po në realizim janë paraqitë se, shkak i paraqitjes së tyre në realizim e ka rrit shkallen e të hyrave në 119.79%, mirëpo në bazë të një llogarie që unë e kam bë, nëse këto nuk hynë, se nëse nuk e ke në planifikim atëhere nuk mundesh mi paraqitë në realizim, atëhere del dikun 94.4% shkalla e realizimit të të hyrave. Këtë rrugë e kanë ndjekur në vitin 2022, 2021, 2020. Në vitin 2019 nuk ka qenë kjo e evidente, ndërsa në vitin 2019 e kanë planifikim dhe e kanë realizu. Pse e ka bë prej vitit 2020 e tutje, nuk e di çfarë qëllimi kanë pas, drejtori e elaboron këtë.

z.Ali Bajrami: Propozim vendimi që e kemi para vete, që e ka propozu kryetari i komunës, është bë me qëllime më të mira, që këto mjete të shpërndahen dhe të shpenzohen aty në bazë të paraqitjes që janë bë. Drejtori e elaboroj këtë propozim, ne jemi pro këtij propozimi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Bazë praktikave që i kemi, një kohë të gjatë e dimë që të hyrat vetanake që nuk shpenzohen, ato duhet të barten, e nese nuk barten mbeten pezull, e nuk kanë mundësi të shfrytëzohen. E për këtë arsye e shpjegoj drejtori, pse këtë vit kanë ardh këto ndarje e këtyre pikave me kërkesën e ministrisë.

z.Jakup Demiri: Bartjen e 2021, pse nuk janë bartë vitin e kaluar, po janë prit dy vite për me u bartë, dhe pse në muajin e pestë, kur e dimë që praktikat na thonjë që duhet në tremujorshin e parë.

z.Besnik Imeri, drejtori: Tek të hyrat e eko pyjeve dhe gjobave në trafik, janë të hyra që per neve janë të pa parashikushme. Nuk mund me e ditë sa gjoba do t'i kemi dhe nuk mundesh me e planifiku. Për këtë janë të pallogaritura, ndërsa vitin e kaluar janë bart dikun 600 mijë euro që kanë bart në vitin 2021 në vitin 2022, 39 mijë nuk jan hargju, edhe këto tani i bartim. Ministria ka kërku që të bëhet në këtë formë bartja, arsyeja e vonesës është në atë se ministria është vonu.

z.Nexhat Halili: Drejtori është e vërtetë që këto janë mjete që inkasohen nga qendra, po janë të hyra të komunës që shpendahen komunës, mirëpo planifikimi ka mujt të bëhet deri në 2019. Planifikimi është bë prej

2020, 2021, 2022, nuk ka planifikim. Hini pasqyrat financiare 2019 e shih që është bërë planifikimi dhe është bërë realizimi, e tash në vitin 2020, 2021, 2022, planifikim nuk ka, për këtë është zero.

z.Jakup Demiri: Nuk e morra përgjigjen, a janë bartë qeto në 2022 te 2021.

z.Besnik Imeri, drejtori: Të 2021 kanë qenë rreth 600 mijë euro janë bart në 2022, e në 2022 janë shpenzu të gjitha, përveç 39 mijë euro e diçka që kanë mbet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për diskutim, qes ne votim për miratim me ngjitje të dorës. Me 20 vota pro, 0 kundër, 0 apstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitin 2021 në vitin 2023

z.Jakup Demiri: Tek kjo pjesë e riparimit të shkollav në Viti, e që janë 9 shkolla, shuma është 183 euro, janë pak.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këto të hyrat të 2021-ës që barten nga viti 2023, nuk mundën me e ndërru shumën, qato që kanë mbetë kanë mu bartë në qat kod, sun e ndryshojmë. Për atë arsye janë këto shuma. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Me ngjitje të dorës, me 20 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitin 2022 në vitin 2023

z.Majlinda Shabani: Sa i perketë kesaj kame një kritik se si është sjell paraneve forma kategorit të paqartësime fillimish e pam edhe në diskutimi paraprak e kemi vlerën 31240 euro të viti 2022 të bartura në vitin 2023 dmth fillimish tu bazu në paqyrat financiare që e kemi të vitit 2022 dmth thuhet që të hyrat e bartura për vitin 2023 janë në vlerë 351 euro e 521 dmth e kemi deference që u përmend 39 mijë e 480 e që faktikisht figurojnë tek paqyrat financiare të vitit 2021 mendoj që këtu ka qenë dashur me u kanë ma të sakta sa i perketë ridistinimit ose të pakte me bërë një sqarim kur është përmend ky propozim vendim e shohim me ndej që në subvencione e kemi shumë prej 121 mijë euro e llogaritur kjo në mënyrë kumulative dmth nuk na tregon se ku realisht shkojnë këto mjete kurgja sa specifikë po e përmendi këtu mënyrë se qyshe është shprehë bëhet për pagesën e bursave të studenteve, subvencioneve në bujqësi, kultur dhe pjesa tjetër subvencione shërbimeve sociale dmth unë këtu e kam pa që bursa nuk është bërë një planifikim buxhetor për bursa që realisht ka qenë dashur me u bërë që i bëjnë komuna po jep bursa si verësi për të tjerët po i shtin të bursat e që ka qenë dashur me u bërë një planifikim buxhetor për sa i perket bursave, tek shuma e subvencioneve në bujqësi ku përmend kodin buxhetor 47033 prap këtu e kemi një mos përputhje të vlerave në pasqyrat financiare të vitit 2022 e kemi shumë prej 55 mijë e 46 euro ndërsa këtu në propozim vendim figuron shuma 39 mijë e 186 euro dmth këtu prap është një mos përputhje e ku pasqyrat ju vet e kenë prezentu e na sot ve po i shohim e natyrisht që nuk jemi kundër që mos mu bërë bartje e mjeteve po se paku me ditë se ku po bëhet. 47 mijë euro fusha sportive po mëndoj që ish kanë mirë mi pa se ku janë ato fusha sportive dhe qytetaret me e ditë cilat fusha janë me prioritet sepse disa lokalitete kanë nevojë për fusha sportive, është shumë më rëndësishëm tek qeshja e operatoreve ekonomik dmth me ligjin e ri të Ministrisë së financave qdo operator ekonomik në momentin që ben flet zotimin dhe e dergon në komunë mandje e pranon zyrtari financiar i ka afat një muaj dmth 30 ditë që ajo page me u krye tash këtu janë përmend obligimet ndaj operatorve ekonomik e që bi ndesh me ligjin që komuna është vonë sa i perketë pagesave e ku operator ekonomik kanë mujt me bërë padi ndaj komunës këtu duhet me dhanë një shpjegim, renovimi i ambulantes në Viti bëhet për mbulimin e planit të shpenzimeve të kryeve projekteve kapitale plani i shpenzimeve nuk është që më ka rastis me pa një herë është mirë me sqarë se çka është ky plani i shpenzimeve.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Qe nuk janë përputh vlerat nuk po e di, e kthen ministria, po janë të parapamë kodet se ku kanë më shku paret i ki në kode.

z. Ali Bajrami: Janë të specifikuara vlerat. Mallra dhe shërbime i kemi 108 mijë euro, subvencione e trasfere i kemi 121 mijë euro dhe investime kapitale i kemi të gjitha këto vlera komulative që janë 312 mijë në nëntë programe, aty ku kanë mbet pa u shpenzu janë bartë në vitin 2023 në kodet që nuk janë shpenzu në vitin 2022 barten në vitin 2023. Nuk ka kurgja të pakjart edhe të pashpejgume e të padefinuar.

z. Ilir Zuka: Këto janë praktika që janë përdorë që disa vite. Unë u befasova tek pika e parë nga koleget që mjetet që kanë, kemi mujt me i vendos dikun tjetër me vendim të Kuvendit, ndërsa këto pikat tjera tani janë vetëm me bë fjalë. Kam qenë i vetmi që kam kërku me parapa dicka tjetër, me ato mjete kam bë propozim në KPF, që të rialokohen dikun tjetër.

z. Nexhat Halili: Buxheti për bujqësi, zhvillim rural, ku janë subvencionet me kod 47033, që ku janë pasqyrat financiare që janë paraqitë prej drejtorisë, janë 54 mijë e 237.04 buxhet i pashpenzuar. Këto janë p.sh.: tek propozim vendimi për bartjen e mjeteve, janë 39 mijë e 186.73, këto janë shifra evidente. Nëse ne e kalojmë sa problem, po besoj që ministria nuk jav kalon këtë.

z. Besnik Imeri, drejtor: Nuk kemi mundësi me bë asgjë, tek kjo pike janë mjete që duhet të barten.

z. Ali Bajrami: Unë tani jam tu fol si Shef i GP të LDK-së, Iliri foli si këshilltar komunal nuk foli si përgjegjës, as si drejtor. Iliri e ka të drejtën me shprehë mendimin e vet si këshilltar i Kuvendit Komunal, për përgjigje e kemi drejtorin e autorizuar, prandaj me qat mënyrë qysh ti ju drejtove Jakup Ilirit, tu kisha lut në mënyrë kolegjiale ma me këtë gjuhë, se nuk na kanë nder askujt kjo.

z. Jakup Demiri: Për këtë muj me i kërku falje Ilirit, po jo ty Ali, se edhe ti po na jep përgjigje që nuk ju takon juve.

znj. Majlin Shabani: Shefi i GP- të LDK-se tha që arsyet janë dhanë. Unë nuk e di a e ki lexu, për besë hajde po e za gabimet gjuhësore nuk po i shofim, po arsyetimi që është dhënë, hiq sa i qartë. Nëse ti e merr me e lexu, nuk e di se ku kanë shku për subvencione 120 mijë euro, ku e din ti ku kanë shku. Unë realisht nuk po e di e për këtë po pyes se ku janë shku ato mjete.

z. Besnik Imeri, drejtor: E para me detajuar dhe më të arsyetuar nuk ka pas. Nëse këshilltarët komunal nuk e dinë se ku shkojnë paret, për qata janë të thirrur, për me monitoru qeverinë edhe me këshyrë ku po shkojnë subvencionet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim me ngritje dore. Me 16 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim votohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në fshatin Binçë me Nr. 01-110/05-278 i dates 30.03.2023

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Para dy seancave, e kemi kalu këtë vendim, kemi pas diskutim, e tani ministria e ka kthy kundërligjshëm. Materialin e keni marrë, nëse keni diçka për me diskutu, atëhere urdhëroni. Pasi që nuk ka për diskutim, kërkoj me ngritje të dorës të votohet. Pra, me 18 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e vendimit për Planin Komunal të Veprimit për Energjinë dhe Klimën (PKVEK) 2022-2030, me Nr. 01-101/05-164, i datës 01.03.2023, dhe vendimin për Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) 2022- 2030, me Nr. 01-110/05-1364, i datës 05.12.2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Materialin edhe për këtë pikë e keni marr me kohë. Hapi debat, nëse ka dikush për me diskutu atëhere urdhëroni. Pasi që nuk ka për diskutim, kërkoj me ngritje të dorës të votohet. Pra, me 18 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Informatë për manifestimi tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2023"

z.Valmir Sahiti drejtor i DKRS-së: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Me lejoni që ta paraqes para juve informatën e manifestimit tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2023". një manifestim statutar, i cili paraqet ngjarjen më të madhe kulturoro sportive që realizohet brenda një viti në Komunën e Vitisë. Me kohë e keni marr informatën dhe raportin e detalizuar. Këtë vit në konsultim me faktorët e ndryshëm e me familjen e Nijazi Azemit, kemi vendos që të gjitha aktivitetet me i përmbledh nga 6 ditë në 3 ditë, pa ndryshuar forma dhe përmbajta e aktivitetit. Bile këtë vit kemi aktivitete shtesë. Materialin e keni marr me kohë, ku i keni të sqaruar në detaje. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës.

z.Jakup Demiri: "Flakadani i Karadakut", nëse nuk gaboj mbahet që 23 here. E di që e ke trashigu ti, këtë e kam thanë më herët edhe po e thamë tash. është qëndrimi i grupit tonë, me gjithë këto shpenzime, janë të paarsyeshme për mu dhe për grupin, për shkak e ki shtypje dhe materiale grafike, katalogu, carada, postere etj 4025 euro, ndriçimi profesional 6018 euro, plus televizioni 2426 euro, dreka shujta për grupe artistike i ki 9011 euro, zërimi 1460 euro, janë shpenzime që unë nuk i arsyetoj. E di që e ke trashigu problematikën ti, mirëpo e ki vitin e dytë që je drejtor. Ka qenë dashur me bë shpenzime më të vogla, se janë shuma të mëdhaja e ku po shifen që ka grupe të interesit që kanë përfitu.

z.Taulant Haxhiu: I nderuar drejtor, unë po e shof një rritje të shpenzimeve në krahasim me vitin paraprak, po ti shumë mirë e elaborove që viti i kalum ka qenë pandemik. Unë të falenderoj që ka qenë një ndër flakadanët më më mirë të organizuar. Unë po ti shof këtu akomodimi 2512 euro, që unë e di që ki pas musafir nga të gjitha trojet shqiptare dhe e ki akomodu me një cmim jashtëzakonisht të vogël, shumë simbolik, dreka e shujta 9011 euro. Nuk ki pa organizim treditorë, ky organizim më herët ka qenë 6-ditorë, pastaj u bë 3-ditorë. 9011 euro për të gjithë ata njerëz që kanë ardh. se ky manifestim ka marr jehonë kombëtare, edhe këtë ta arsyetoj unë. Ndricimi profesional 6018 euro është imazh. Kush ka ardh nga musafirët e ka pa që u kanë një dicka që se ka pas asnjë qytet i Kosovës si ka qen në flakadan. Unë kërkoj nga kryetari i komunës, se ky flakadan është i një dëshmori Nijazi Azemi "Komandant Mjekrra". Ky ka marr një jehonë kombëtare, po ky duhet ta merr edhe një jehonë ndërkombëtare, se është një nder manifestimet me të mira në Republikën e Kosovës.

z.Basri Sylejmani: Unë po thamë që Flakadani duhet të jete për të gjithë, jo vetëm për një njeri. Ka edhe dëshmorë të tjerë ku janë nga një familje, dy, "Gursel e Bajram Sylemani", janë mbytë dy vllaznia. A ka kalu me 1500 euro manifestimi me shpenzime, drejtori nuk i ka fajet për këtë. Unë edhe Jakupin e përkrahi, është mirë ne me bë për të gjithë këtë. Unë nuk jam kundër kësaj, po me mujt me bë për një ditë për krejt.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit drejtor! Kjo pikë nuk votohet, se është informatë

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Raporti vjetor i punës për vitin 2022, Njësia për Auditim të brendshëm në Komunën e Vitisë, (pa diskutim në KPF)

z. Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ju kam premtu që kemi me sjellë këtë raport, edhe pse aspekti ligjor po e thotë ndryshe, po duke e pas paraysh performancën e komunës, sot para juve e kam sjellë këtë raport të shkurt. E keni planin e veprimit që është bërë. Me siguri keni pas rast dhe kohë me lexu, materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shitesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z. Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

znj. Majlinda Shabani: Mu si pika me më rëndësi mu ka doke, ku thuhet që në kuadër të planit vjetor për vitin 2022 janë planifiku edhe dy auditime me kërkesë nga menaxhmenti i lartë, mirëpo ka thanë që gjatë këtij viti nuk kemi pas kërkesë për auditime me kërkesë nga menaxhmenti i lartë. D.m.th këtu nashti ish kanë mirë me pas kërkesë, edhe ka qenë e arsyeshme për shkak që e dimë që buxheti për komunën cdo vit është duke u shumëfishu. D.m.th fjala është për investime kapitale, numri i rekomandimeve ka qenë gjithsej 12 rekomandime, mirëpo vetëm 4 të zbatuara. Dicka që për mu ka qenë shqetësuese, është ku thuhet që menaxhmenti i disa drejtorive përkatëse nuk kanë ndërmarr veprime të mjaftueshme në maximizimin e përfitimit të punës së Njesisë së Auditimit ose për të kërkuar siguri të arsyeshme për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme, që i bie faktikisht që drejtorat ose nuk janë tu i kry punët në bazë të rekomandimeve si që Juhet, kemi ende mangësi në procesin e të hyrave në menagjimin e shpenzimeve si p.sh. në menaxhimin e procedurave të të hyrave të tatimit në pronë, në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në zbatimin e procedurave të shpenzimeve në administratën komunale etj. Pikërisht janë këto rekomandime që nuk merren parasysh, madje kur po kemi diskutim sa i përket shpenzimeve, gjithmonë po kemi qalime. Sa i përket këtyre pikave, gjithashtu te rekomandimi nr. 4, ku thuhet që "rekomandojmë menaxherin e prokurimit, që gjatë fazës së menagjimit të kontratave të ketë parasysh implementimin e kontratave, sidomos rikonfirmimin i disponueshmërisë së fondeve përbëhet para publikimit të dhënies së kontratës, e jo pas publikimit të dhënies së kontratës, madje thuhet që menagjeri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i kontratës mos të jetë njëkohësisht anëtar i komisionit për ndryshimin e projektit. D.m.th kjo është në kundërshtim me ligjin. Thuhet që i rekomandojmë zyrtarët komunal që, të bëhet menaxhimi i faturave me kohë në librin e protokollimit të faturave, sepse kjo krijon një imigj jo të mirë të operatorët ekonomik.

z. Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Faleminderit Majlind! Gjithcka që është e shkruar këtu, nuk mundem me kontestu, se ai është konstatim i një eksperti, po unë kisha mu lidh, kërkesa nga menaxhmenti i lartë cdo here Zyra e Auditimit. Këtë rast drejtori i Njesisë së Auditimit dikun në shtator - tetor e ka afatin e fundit që e përgatit planin e vet për vitin në vijim që vjen dhe menaxhmenti i lartë. Në këtë rast kryetari i Komunës nëse parashef një parregullsi, dikun ka të drejtë me ndërhy dhe me i thanë të auditohet qekjo njësi. Te çështja e auditimit në pronë, një parregullsi është se, me kanë bind që fajtor sa Drejtoria e Financave dhe sektori i tatimit në pronë, disa objekte të cilat ende nuk kanë kalu asete të komunës, që janë të ndërtuara në Komunën e Vitisë, këto me tatim në prone i paska ngarku divizioni për tatim në pronë në kuadër të ministrisë, po që ja ka bart si borxh në kuadër të Komunës së Vitisë, që kjo çështje ish ende e padefinuar dhe e pashpjeguar. Dje e kam pas takimin për raportin e auditorit të jashtëm. U tha që komuna lidh kontratë pa sigurim të mjeteve, mjetet janë të siguruara po nuk i kanë zotu, se në planifikim ti je ajo që e ki ngrit dorën dhe i ki nda për atë projekt, po ka mujt me ndodhe lidhja e kontratës pa zotim. Po këto janë gjetje që na si ekzekutiv duhet me i përmirësu. E kemi bërë planin për zbatimin e rekomandimeve.

z. Nexhat Halili: Është e vërtet që raporti i auditimit nuk është i obliguar me ardh në Kuvend. Mirë është raport i brendshëm për menaxhmentin. Nënkryetar, është e vërtet që keni mungesë të stafit në Zyrën e Auditimit. Për momentin e keni vetëm drejtorin e auditimit, i cili nuk do të shkon edhe dy tre muaj, e është në pension. Cka do

të veproni ju përshembull. Do të mbetni pa auditor, edhe pse e keni shpall konkursin me një person në Zyrën e Auditimit. Është problem me i mrri planifikimet. Ky raport është i mangët, nuk po muj mu kyq detalisht. P.sh.: nëse e marr një procedurë të prokurimit, prej fillimit deri në fund me bë një analizë me e ditë pak për afërsisht se ku janë mangësitë. Tash e potencoj edhe kolegja për deklaratën e nevojave, se gjithmonë deklaratën e nevojave fillon para fillimit të procedurës, por verifikohet para nënshkrimit të kontratës, edhe njëhere verifikohet se a janë qeto mjete në dispozicion. Në këtë rast nuk është verifiku para, por është verifiku pas procedurës se prokurimi. Të gjitha procedurat e prokurimit nuk lejohet me ligj të fillohet pa zotim të mjeteve, e kuptoj ndarje e mjeteve mirëpo pa zotim të mjeteve nuk lejohet. E kuptoj që ka kontrata më shumë se një vit, edhe ato nuk mundesh ti me e zotu mjetet të gjitha për këtë vit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit shumë për kontributin e dhënë nga të gjithë, shihemi në seancat e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 13:40

Procesmbajtési
Fatlum Demiri

Kryesuesi I Kuvendit Komunal
Bekim Azizi
